

VENDIM
Nr. 576, datë 10.7.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR IDENTIFIKIMIN, VLERËSIMIN DHE DHËNIEN E KONCESIONEVE PËR HIDROCENTRALET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 pika 2, e 49 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen të gjitha institucionet, qendrore dhe vendore, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLAT
PËR IDENTIFIKIMIN, VLERËSIMIN DHE DHËNIEN E KONCESIONEVE PËR
HIDROCENTRALET

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Autoriteti kontraktues është përgjegjës për vlerësimin e kushteve, kriterëve, mënyrave dhe procedurave për dhënien me koncesion për hidrocentrale të projekt(e)-propozim të pakërkua në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të akteve nënligjore në zbatim të tij dhe të këtyre rregullave.

KREU II
IDENTIFIKIMI I KONCESIONIT TË MUNDSHËM

1. Identifikimi i projektit të koncesioneve të hidrocentraleve për rastet e propozimeve të pakërkua bëhet nga vetë propozuesi i projektit të koncesionit duke vlerësuar elementet strategjike, sektoriale apo rajonale të zhvillimit.

2. Pas identifikimit të projektit të koncesionit për hidrocentrale, i mundshëm për propozimet e pakërkua, bëhet analiza e rentabilitetit dhe e përshtatshmërisë financiare, për të vendosur nëse duhet dhënë koncesioni. Kjo analizë mbështetet në parimet e vlerës maksimale të projektit përkundrejt parave që kërkohen, në përputhshmërinë e koncesioneve të mundshme me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin, teknik dhe tregtar, të koncesionit të mundshëm dhe aftësinë e tij për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private. Njësia e trajtimit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat asiston ministritë ose autoritetet vendore për realizimin e një analize të tillë.

3. Në këto raste, nëse nga analiza e rentabilitetit dhe e përshtatshmërisë financiare ky koncesion vlerësohet si jo i mundshëm, organi përgjegjës sipas fushës së veprimtarisë që mbulon, vendos për mosfillimin e procedurave për dhënien e koncesionit dhe njofton propozuesin për vendimin e marrë.

4. Në përfundim të kësaj procedure dhe pasi vlerësohet si i mundshëm projekti i hidrocentralit, organi përgjegjës miraton fillimin e procedurave koncesionare.

Dhënia e bonusit në rastet e propozimeve të pakërkua për hidrocentrale

1. Në rast pranimi, fillon procedura përzgjedhëse e cila favorizon paraqitësin e propozimit të pakërkuar, duke i dhënë një bonus për rezultatin tekniko-financiar të arritur gjatë periudhës përzgjedhëse

deri në një maksimum prej 10% të pikëve.

2. Autoriteti kontraktor i paraqet dokumentacionin e plotë Këshillit të Ministrave, i cili miraton me vendim pikët që jepen si bonus për propozuesin.